


REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive	
Ref. Nr. Org. Org. Kod Org. Unit	018/101
Nr. Prot. Prot. No.	1401-3/2023
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	1
Data Datum Date	05/07/2023
Odësa	PRISHTINË/A



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -**  
**Ministry of Finance, Labour and Transfers**

**Departamenti i Buxhetit - Budget Departament - Budzet Departament**

<b>DATË</b>	05.07.2023
<b>REFERENCË</b>	Nr. 105/2023
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Z. Nuhi Mani, Zyrtar Kryesor Financiar, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>CC</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Z. Enis Spahiu, zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinionimi i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor të projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti

I nderuari z. Mani,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor të projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, të paraqitur nga propozuesi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), obligimin sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Departamenti i Buxhetit paraqet me sa vijon:

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

Qëllimi i këtij projekt ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në zbatim të Aktgjykimit KO190/19 të Gjykatës Kushtetuese duke rregulluar dispozitat ligjore të cilat janë në mos përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj parashihet të krijohet një skeme e re pensionale - Pensionet parciale kontribut pagues në të cilën skemë do të përfshihen:

- Personat që kanë kontribuar sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor Nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 26/83) para datës 01.01.1999 por nuk e arrijnë stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh kontribute si periudhë kushtëzuese për shkak se janë larguar nga

puna si rezultat i masave të dhunshme, mund të kualifikohen në skemën e pensionit parcial kontribut pagues të moshës sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara.

## **OPINIONI I PAVARUR I DEPARTAMENTIT TË BUXHETIT NË VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB)**

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si organ propozues, ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetorë për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti për periudhën 2023-2060 që në total ka kosto në shumë prej 1,301,862,044 euro.

Sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2024-2026 për këtë skemë të re pensionale janë ndarë shuma prej 180,000,000 euro.

Për vitin 2023 planifikohet të ketë kosto prej 26,250,000 euro, këto mjete sigurohen nga nën programi Kontigjenca në MFPT e cila është e parapare për vitin 2023 dhe mund të përdoren për mbulimin e ndikimit financiarë që kane ligjet e reja që miratohen nga Qeveria për vitin 2023 e që nuk kane ndarje buxhetore të planifikuar.

Sipas udhëzimit administrativ QRK Nr 09/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ QRK Nr.03/2015 për vlerësimin e ndikimit buxhetore të nismave të reja qeveritare për nismat që synojnë të rregullojnë skemat apo përfitimet pensionale vlerësimi i ndikimit buxhetor kryhet për një periudhë së paku 50 vjeçare.

Për këtë nismë janë dhënë vlerësimet deri në vitin 2060 pasi që vlerësohet se kjo skemë do të jetë aktive deri në këtë vitë .

**Kostoja totale e projektligjit është në shumë prej 1,301,862,044 euro për vitet 2023-2060 e shpërndarë nëpër vite si vijon:**

Viti	Kostoja vjetore	Viti	Kostoja vjetore
2023	26,250,000	2042	26,946,524
2024	60,000,000	2043	24,956,627
2025	60,000,000	2044	21,213,133
2026	60,000,000	2045	18,031,163
2027	69,498,297	2046	15,146,177
2028	77,685,208	2047	12,722,788
2029	78,835,693	2048	11,314,194
2030	78,458,443	2049	9,390,781
2031	76,925,451	2050	7,700,440
2032	73,322,740	2051	6,314,361
2033	74,962,953	2052	5,114,633
2034	68,553,393	2053	4,419,043
2035	62,132,747	2054	3,535,234
2036	55,428,553	2055	2,828,187
2037	49,344,453	2056	1,979,731
2038	47,041,712	2057	1,385,812
2039	41,396,707	2058	883,455
2040	36,015,135	2059	530,073
2041	31,333,167	2060	265,036
<b>Totali 2023-2060</b>			<b>1,301,862,044</b>

**Përfundim:**

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, për vitin 2023 planifikohet të ketë kosto prej 26,250,000 euro, këto mjete sigurohen nga nën programi Kontigjenca në MFPT e cila është e parapare për vitin 2023 dhe mund të përdoren për mbulimin e ndikimit financiarë që kanë ligjet e reja që miratohen nga Qeveria gjatë vitit 2023 e që nuk kanë ndarje buxhetore të planifikuara.

Ndërsa për vitet 2024-2026 për këtë skemë të re pensionale është planifikuar shuma prej 180,000,000 eurove në dokumentin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2024-2026.

Ndërsa sa i përket viteve vijuese nga viti 2027 e tutje për këtë skemë të re pensionale planifikimet buxhetore duhet të bëhen me proces të rregulltë buxhetorë.

Përgatitur nga:

*rw* Antigona Bekaj, Analiste e lartë e buxhetit

